



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTER
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR. 35 DATË 30.04.2026

PËR

" KRIJIMIN E GRUPIT MBESHTËTËS ZJARRFIKËS ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN NË
BASHKINË GJIROKASTËR"

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronja "b", nenit 29, pika 2, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 13, pika 2, të Ligjit nr.152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës 30/04/2026

VENDOSI:


1. Të miratojë krijimin e Grupit Mbështetës zjarrfikës me kontratë për periudhën Maj –shtator për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në Bashkinë Gjirokastrë.
2. Të miratojë strukturën e Grupit Mbështetës zjarrfikës me kontratë, sipas Aneksit nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë uniformën dhe shenjat dalluese, sipas Aneksit nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe Drejtoria e Urbanistikës (Sektori i Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " të ndryshuar.

KRYETAR

Merita ISARAJ

SEKRETAR I KËSHILLIT

Bexhet BAXHELLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTER

Nr. 3984/Prot

Gjirokastër më 22.042026

Lënda : **Dërgohet për shqyrtim dhe miratim të materialit me objekt "Për krijimin e Grupit Mbështetës Zjarrfikës me kontratë të përkohshme për mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në Bashkinë Gjirokastër"**


KËSHILLIT BASHKIAK GJIROKASTËR
Sekretarit të Këshillit, Znj. Bexhet Baxhella

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, te Kushtetutës , të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja " b", nenit 29, pika 2, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 13, pika 2, të Ligjit nr.152/2015, "Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", Ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", ju vendosim në dispozicion për shqyrtim dhe miratim dokumentin "Për krijimin e Grupit Mbështetës Zjarrfikës me kontratë të përkohshme për mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në Bashkinë Gjirokastër.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

KRYETAR

Flamur Golemi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTER

Nr. 3884 Prot

Gjirokastër më 22.042026

Lënda : Për shqyrtim dhe miratim të materialit ‘Për krijimin e grupit mbështetës, Zjarrfikës me kontratë të përkohshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në Bashkinë Gjirokastër’

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës , të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 29, pika 2, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 13, pika 2, të Ligjit nr.152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", VKB nr. 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026” me propozimin e Kryetarit të Bashkisë kërkojmë krijimin e Grupit Mbështetës Zjarrfikës me kontratë të përkohshme për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin në Bashkinë Gjirokastër”.

Grupi mbështetës, zjarrfikës me kontratë të përkohshme për periudhën Maj-Shtator është pjesë e shërbimit të Drejtorisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, ka si mision vrojtimin, raportim në kohë dhe ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve në territorin e Bashkisë Gjirokastër.

Struktura e grupit mbështetës, zjarrfikës me kontratë të përkohshme do të jetë sipa Aneksit nr.1, bashkëlidhur këtij materiali i cili përcakton detyrat e secilit.

Grupi mbështetës, zjarrfikës me kontratë të përkohshme do të drejtohet nga Drejtori i MZSH-së i cili është përgjegjës për funksionimin dhe administrimin këtij shërbimi.

Ky grup mbështetës do të ketë uniformën dhe shenjat dalluese, sipas Aneksit nr.2.

Të drejtat dhe detyrimet, kushtet dhe kriteret e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve dhe shërbimeve përcaktohen në kontratën që lidhet midis Bashkisë Gjirokastër dhe anëtarëve të grupit mbështetës zjarrfikës.

Secila nga njësitë administrative do të ketë sipas organigramës një nga pjesëtarët e grupit mbështetës.

Nëpërmjet këtij grupi Drejtoria e MZSH, përforcon ndërhyrjen në të gjitha njësitë për të qenë sa më efektive në kohë për parandalimin dhe njoftimin e menjëhershëm në çdo situatë që mund të paraqitet gjatë sezonit veror ku prania e zjarreve është më e shtuar. Ndërhyrja në kohë në çdo situatë të paraqitur zvogëlon dëmtimet nga zjarri në pyje dhe kullota dhe në të gjithë territorin.


Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij do të jetë personi përgjegjës për lidhjen e kontratës me grupin mbështetës zjarrfikës.

Dr. Burimeve Njerëzore : Mirlinda Shabani

Dr. Juridike: Alma Llace

Dr. MZSH-së : Gramoz Llapi

**KRYETAR
Flamur Golemi**




ORGANOGRAMA

GRUPI MBESHTETES ZJARRFIKES ME KONTRAT I SHERBIMIT PER MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SHPETIMI NE BASHKINE GJIROKASTER PER PERIUDHEN MAJ –SHTATOR 2025


KRYETARI I BASHKISE GJIROKASTER

Drejtori i MZSH-se



STRUKTURA:

1-Zjarrfikes me kontrat te perkohshme Maj - Shtator 7




Gjithsej 7(shtate)

STEMA E ZJARRFIKESIT



Uniforma e zjarrfikesit mbeshtetes perbehet nga :

- 1.Xhaket pune
- 2.Pantallona pune
- 3.Kapele me shenjen e zjarrfikesit .
- 4.Jelek
- 5.Kepuce me qafa.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTER
KESHILLI BASHKIAK**

**P/VENDIM
NR. ____ DATË ____ . ____ .2026**

PËR

**" KRIJIMIN E GRUPIT MBESHTËTËS ZJARRFIKËS ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN NË
BASHKINË GJIROKASTËR"**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronja "b", nenit 29, pika 2, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 13, pika 2, të Ligjit nr.152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ____ : ____ :2026

VENDOSI:

1. Të miratojë krijimin e Grupit Mbështetës zjarrfikës me kontratë për periudhën Maj –shtator për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në Bashkinë Gjirokastër.
2. Të miratojë strukturën e Grupit Mbështetës zjarrfikës me kontratë, sipas Aneksit nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë uniformën dhe shenjat dalluese, sipas Aneksit nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe Drejtoria e Urbanistikës (Sektori i Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " të ndryshuar.

KRYETAR

Merita ISARAJ

SEKRETAR I KËSHILLIT

Bexhet Baxhella